



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME DHE DIASPORËS PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të MPJD kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministrja e MPJD-së është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Sa i përket menaxhimit financiar, edhe pse janë vërejtur përmirësime në raport me vitet paraprake, duhet t'i kushtohet vëmendje e shtuar çështjes së prezantimit të detyrimeve kontigjente si dhe klasifikimit të shpenzimeve.

Ndërsa lidhur me pajtueshmërinë me legjislacionin dhe rregulloret e zbatueshme, fokus më i madh t'i kushtohet procesit të subvencionimit, monitorimit të realizimit të kontratave si dhe nxjerrjes së rregulloreve për stafin vendor në përfaqësi diplomatike.

Ky raport ka rezultuar me pesë (5) rekomandime, prej tyre pesë (4) rekomandime të reja dhe një (1) rekomandim i përsëritur. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 8,655,394€, prej tyre ishin shpenzuar 8,653,248€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 389, ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 314.

Çështja A1 - Mungesa e rregulloreve për pranimin e stafit lokal në Misione Diplomatike

Gjetja Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) nuk ka të miratuar një rregullore specifike që rregullon rekrutimin e stafit lokal në misionet diplomatike. Një dokument i tillë është i domosdoshëm për të përcaktuar qartë procedurat e pranimi, kriteret e përzgjedhjes, të drejtat dhe detyrimet e stafit lokal, si dhe për të rregulluar aspektin e pagesës dhe përgjegjësi të tyre.

Gjatë testimit të dy procedurave të rekrutimit për stafin lokal, njëra në Ambasadën e Kosovës në Bern dhe tjetra në Konsullatën në Cyrih, në të dy rastet kemi vërejtur se procesi i pranimi apo rekrutimit nuk është bazuar në ndonjë rregullore të veçantë të MPJD-së. Po ashtu, kontratat e punës nuk përmbajnë preambulë ku të bëhet referimi ligjor mbi të cilin është bazuar rekrutim. Për më tepër, pagat e stafit paguhen nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.

Mos hartimi dhe ndërmarrja e veprimeve për hartimin e rregullores ishte arsyeja e cila ka reflektuar në dobësitë më lartë.

Ndikimi Rekrutimi i stafit lokal në MDK në mungesë të një rregulloreje të qartë dhe të detajuar për pranimin e stafit lokal në misionet diplomatike krijon paqartësi në procedurat e pranimi dhe rrit rrezikun për trajtim të pabarabartë. Njëherit, kjo mund të sjellë pasiguri në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e stafit lokal, si dhe mund të krijojë vështirësi në vlerësimin e performancës së tyre.

Rekomandimi A1 Ministrja duhet të siguroj hartimin e një rregullore të qartë për rekrutimin e stafit lokal në misionet diplomatike, e cila do të përcaktojë procedurat e rekrutimit, kriteret dhe detyrimet e tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime, përfshirë edhe komunalitë, në vitin 2024 ishte 29,091,092€. prej të cilave ishin shpenzuar 22,836,496€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shërbime të udhëtimit, rimbursime të ambasadave, shërbime tjera kontraktuese etj.

Çështja A2 - Mangësi në monitorim të kontratës

Gjetja

Neni 54.15 i rregullores për prokurim publik ka përcaktuar: Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dine sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në baze të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi dhe mund të realizohet deri në vlerë të parashikuar.

MPJD me datë 30.11.2023 kishte lidhur kontratë "Furnizime të ndryshme për nevojat e MPJD-së" bazuar në çmimin e peshuar për njësi. Vlera e parashikuar ishte 120,000€, çmimi me peshim 74.13. Në këtë kontratë ishte caktuar pesha për njësi, mirëpo me rastin e realizimit të kontratës nuk ishin mbajtur evidenca (raporte) detaje lidhur me shfrytëzimin e kontratës sipas peshave të caktuara në pozicione.

Kjo kishte ndodhur për shkak të ndërrimit të menaxherit të kontratës me rastin e angazhimit në përfaqësi diplomatike.

Ndikimi

Monitorimi jo i duhur i kontratave mund të ndikoj që furnizimet të bëhen jo në përputhje me kushtet e kontraktuara.

Rekomandimi A2

Ministrja duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave mbajnë evidenca me detaje të plota dhe të sakta lidhur me realizimin e kontratave, në mënyrë që furnizimet/shërbimet të jenë në përputhje me kushtet e kontraktuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 1,241,200€, prej tyre në 2024 ishin shpenzuar 1,168,623€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me përkrahjen e projekteve për diasporën.

Çështja A3 - Dobësi në menaxhimin e subvencioneve

Gjetja

Sipas Rregullores MF - Nr - 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 20, paragrafi 3, përcakton që komisioni vlerësues kërkon nga aplikuesit e përzgjedhur në listën e rezultateve paraprake dokumentacionin në vijim: 1) Dëshmi se kanë kryer të gjitha obligimet tatimore dhe kontributet pensionale sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës; ose në rast të ekzistencës së detyrimeve, dëshmia e një marrëveshje me autoritetet tatimore për përmbushjen e detyrimeve të tilla. 2) Dëshmi të dorëzimit të deklaratës vjetore tatimore ose pasqyrave financiare për vitin paraprak të dorëzuara sipas kërkesave të legjislacionit tatimor për vitin paraprak. Tutje, sipas kontratës së nënshkruar në mes të MPJD dhe OJQ-së përfituese, përkatësisht neni 4 të kontratës, specifikon se, për të kontrolluar përdorimin e duhur të burimeve përfituesi është i detyruar të dorëzojë raport ofruesit të mbështetjes financiare për zbatimin projektit i cili duhet të përfshijë: Raportin narrativ dhe Raportin Financiar me dokumentacion të detajuar të të gjitha kostove dhe anekset përkatëse.

Gjatë testimit të subvencioneve, ne kemi vërejtur mangësitë si në vijim:

- Te financimi i Projektit "Kampi Rinor me të Rinjtë nga Zonat Rurale të Kosovës dhe të Diasporës", në vlerë 17,500€, në dosjen e aplikimit përfituesi kishte paraqitur një Vërtetim Tatimor të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës. Megjithatë vërtetimi në fjalë kishte të skaduar periudhën e vlefshmërisë. Përveç kësaj, edhe pse ishte kërkuar paraqitja e dëshmive për dorëzimin e deklaratës vjetore tatimore ose pasqyrave financiare, nuk kemi siguruar asnjë dëshmi që konfirmon dorëzimin e këtyre deklaratave nga ana e përfituesit; dhe
- Përfituesi i subvencionimit nuk kishte dorëzuar raportin financiar dhe as atë narrativ ashtu siç kërkohet në kushtet e kontratës.

Mangësitë e cekura më lartë janë pasojë e funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme. Madje, MPJD-ja edhe pse e kishte përgatitur planin vjetor të mbështetjes financiare për vitin 2024, ky plan nuk ishte dorëzuar në Zyrën e Kryeministrit, siç kërkohet nga me rregullore.

Ndikimi

Mangësitë në zbatimin e kriterëve të subvencionimit si dhe mos dorëzimi i raporteve financiare dhe narrative nga përfituesi i subvencionit ndikon në transparencën dhe llogaridhënien e fondeve publike. Njëherit, kjo mund të çojë në financimin e subjekteve që nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara ligjore si dhe mund të ndikojë në arritjen e qëllimeve për të cilat janë destinuar mjetet.

Rekomandimi A3

Ministrja duhet të sigurojë kontrolle dhe monitorim adekuat të procesit të subvencionimit, raportimit dhe përzgjedhjes së përfituesve vetëm pasi të janë plotësuar kriteret e përcaktuara duke siguruar se financimet publike

arrijnë qëllimin e synuar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 3,677,725€ dhe prej tyre gjatë vitit 2024 ishin shpenzuar 3,143,539€. Këto shpenzime kanë të bëjnë me blerjen e objekteve të ambasadave në MDK, blerje të veturave për MDK, furnizim me pajisje të teknologjisë informative etj.

Çështja B1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja	<p>Sipas nenit 18, pikës 3 të Rregullës Financiare Nr. 01/2013 Shpenzimi i Parave Publike, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që Organizatat Buxhetore (OB) duhet të i aplikojnë.</p> <p>MPJD gjatë vitit 2024, ka realizuar një pagesë në vlerë prej 3,380€ për projektin “Furnizim dhe Dizajnim për Zyrë”, nga kategoria e investimeve kapitale, i cili për nga natyra e shpenzimit i takonte kategorisë së mallrave dhe shërbimeve.</p> <p>Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve ishte rezultat i planifikimit jo adekuat të buxhetit.</p>
Ndikimi	<p>Pagesat e kryera nga kategoritë jo adekuate ekonomike kanë ndikuar në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve duke shkaktuar mbivlerësim të kategorisë së investimeve kapitale si dhe nënvlerësim të kategorisë së mallrave dhe shërbimeve.</p>
Rekomandimi B1	<p>Ministrja duhet të sigurojë planifikim adekuat të shpenzimeve me buxhet, në mënyrë që shpenzimet të bëhet dhe regjistrohet në kodet ekonomike adekuate për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël.</p>

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.5 Detyrimet kontigjente

Vlera e detyrimeve kontigjente e prezantuar në PVF ishte 26,120€.

Çështja A4 - Mangësi në prezantimin e detyrimeve kontigjente

- Gjetja** Bazuar në Rregulloren MF Nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore (OB), OB-të mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare. Sipas nenit 18 të kësaj rregullore OB duhet të raportojnë të gjitha detyrimet kontigjente.
- MPJD në PFV-të e saj kishte bërë shpalosjen e listës së detyrimeve kontigjente por që kjo listë nuk përfshinte të gjitha paditë që janë në procedurë ndaj MPJD-së siç ishin prezantuar në regjistrin e marrë nga Departamenti për Çështje Ligjore dhe Traktate. Lidhur me këtë, dy (2) raste të evidentuara në vlerë 40,889€ nuk ishin raportuar si detyrime kontingjente duke bërë nënvlerësimin e tyre në PFV.
- Kjo kishte ndodhur për shkak se regjistri i detyrimeve kontigjente nuk ishte azhurnuar në përputhje me ndryshimet e zhvilluara të rasteve në proceset gjyqësore gjatë vitit.
- Ndikimi** Mos përfshirja e të gjitha detyrimeve kontingjente ndikon në cilësinë dhe saktësinë e informatave të shpalosjeve në PFV si dhe vlera e tyre financiare të nënvlerësohet.
- Rekomandimi A4** Ministrja, duhet të siguroj një koordinim më të mirë në mes zyrës ligjore dhe asaj të financave me qëllim që regjistrat e detyrimeve kontigjente të mbahen të saktë dhe të azhurnuar me informatat e reja, në mënyrë që shënimet në PFV të prezantohen të sakta.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	47,483,313	42,665,411	35,801,906	37,935,849	31,042,160
Grante Qeveritare - Buxheti	47,483,313	42,432,942	35,673,659	37,541,693	30,256,159
Donacionet vendore	0	31,310	25,330	94,795	104,813
Donacionet e jashtme	0	201,159	102,917	299,361	681,188

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 4,817,902€, kryesisht si rezultat i vendimeve të Qeverisë dhe grandeve të përcaktuara të donatorëve.

Në vitin 2024, MPJD ka shpenzuar 84% të buxhetit final, ose 35,801,906€. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	47,483,313	42,665,411	35,801,906	37,935,849	31,042,160
Pagat dhe mëditjet	7,358,254	8,655,394	8,653,248	6,130,024	6,969,920
Mallrat dhe shërbimet	22,577,008	28,328,448	22,193,582	18,724,977	18,205,016
Komunalitë	1,010,551	762,644	642,914	698,193	702,400
Subvencionet dhe transferet	1,342,500	1,241,200	1,168,623	621,910	494,324
Investimet Kapitale	15,195,000	3,677,725	3,143,539	11,760,746	4,670,500

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,297,140€. Kjo rritje ishte rezultat i vendimeve të Qeverisë. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 100%;
- Në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, buxheti final krahasuar me atë fillestar ishte rritur për 5,751,440€. Kjo rritje ishte rezultat i vendimeve të Qeverisë dhe grandeve të përcaktuara të donatorëve. Shpenzimi në këtë kategori ishte 78% e buxhetit final;
- Buxheti final për shpenzime komunale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 247,907€ me vendime për kursime buxhetore. Realizimi i buxhetit final në kategorinë e shërbimeve komunale ishte 84%;
- Te kategoria e subvencioneve dhe transferove, kishte zvogëlim të buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar për 101,300€. Ky zvogëlim ishte bërë me vendime për kursime buxhetore. Në kategorinë e shërbimeve komunale shpenzimi ishte 94% e buxhetit final; dhe
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 11,517,275€. Ky zvogëlim ishte si rezultat i vendimeve Qeveritare për kursime. Shpenzimet në kategorinë e investimeve kapitale ishin 85% e buxhetit final.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



MPJD për vitin 2024, kishte realizuar të hyra në vlerë prej 4,241,164€ dhe krahasuar me vitin paraprak kemi një zvogëlim prej 1,821,486€ në pranimet e të hyrave. Ky zvogëlim ishte për shkak të vendimit për përcaktimin e tarifave për shërbimet konsullore Nr.249/2024, i cili kishte zvogëluar tarifat për këto shërbime.

Të hyrat e realizuara nga MPJD janë kryesisht nga taksa për dokumente të udhëtimit, taksa për verifikim të dokumenteve, taksa për letërnjoftim, taksa për shtetësi, taksa për vulë apostile dhe taksa tjera.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	6,910,278	6,910,278	4,241,164	6,062,650	6,221,935
Të hyrat jo tatimore	6,910,278	6,910,278	4,236,269	5,642,929	5,912,080
Të hyrat tjera	0	0	4,894	419,722	309,855

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2023 të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka rezultuar me gjashtë (6) rekomandime.

Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, nga gjashtë (6) rekomandime të dhëna, pesë (5) rekomandime janë zbatuar ndërsa një (1) rekomandim ka mbetur i pa zbatuar.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Ministrja në bashkëpunim me Thesarin duhet të siguroj se janë ndërmarrë masa konkrete për identifikimin e shkaqeve për mos-mbylljen e avanseve të hapura të bartura ndër vite bazuar në dokumente mbështetëse si dhe të merren masa për mbylljen e tyre. Po ashtu, në vazhdimësi të forcohen kontrollët në regjistrimin e shpenzimeve të MDK-ve që të evitohen mos-barazimet dhe të pasqyrohet një evidencë e plotë e parasë së shpenzuar.	Ky rekomandim është zbatuar, ka mbetur një vlerë e vogël e avanseve për udhëtime zyrtare të cilat janë prezantuar saktë.	I zbatuar
2.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministrja duhet të sigurojë se në rastet e bashkë-organizimeve të aktiviteteve me palë të jashtme të përcaktohen qartë përgjegjësitë e palëve në kontraktimin e shërbimeve dhe mënyrën e kryerjes së pagesave në mënyrë që shpenzimet të bëhen në kodet ekonomike adekuate për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël.	Edhe këtë vit kemi hasur në keqklasifikim të shpenzimeve.	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministrja duhet të siguroj një kontroll efektiv të obligimeve që rrjedhin nga aktivitetet e Ministrisë në mënyrë që të gjitha faturat e pranuar të paguhen brenda afatit të përcaktuar ligjor për të shmangur penalizimet për shkak vonesave.	Nga mostrat e testuara nuk kemi hasur raste të tilla.	I zbatuar
4.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministrja edhe më tej duhet të siguroj përmes shefave të MDK-ve që mbajtja e evidencave të bëhet për secilin automjet zyrtar dhe përdorimi i tyre të raportohet në mënyrë të rregullt mujore në Divizionin e Transportit/Logjistikes në MPJD.	Nuk kemi hasur raste të tilla të mos raportimit.	I zbatuar
5.	Investimet kapitale	Ministrja në bashkëpunim me "Komisionin Rregullativ për Prokurim Publik" (KRPP) duhet të ndërmarrin masa në gjetjen e një alternative të qëndrueshme për përfshirjen e të gjitha kontratave të realizuara nga MDK-të në kuadër të raportit vjetor të kontratave të realizuara publike me qëllim të pasqyrimin të gjendjes reale të kontratave të realizuara të ministrisë.	Ky rekomandim është zbatuar.	I zbatuar
6.	Obligimet e papaguara	Ministrja duhet të siguroj që kontrollët në zyrën e financave të jenë më efektive në mënyrë që të evitohen gabimet dhe të bëhet raportimi i drejtë dhe i saktë i gjendjes së obligimeve të pa-paguara.	Ky rekomandim është zbatuar.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Shkelqim Xhema, Drejtor i Auditimit



Arian Haxha, Udhëheqës i ekipit



Fatlinda Podvorica, Anëtare e ekipit



Arian Zenelaj, Anëtar i ekipit



Shemsije Llugiqi, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATË PRILORË DHE NËNËMBËR KLASIFIKIM I DOKUMENTIT SUBSEKSIONI IDENTIFIKUES: 30-05-2025			
Vëllimi Org. Org. Jedis. Org. Unit	Shif. Masif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Prot. No. No. Pages	Nr. i Stranica Str. No.
03	47	840	1



REPUBLIKA E KOSOVËS ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATË PRILORË DHE NËNËMBËR KLASIFIKIM I DOKUMENTIT SUBSEKSIONI IDENTIFIKUES: 30-05-2025			
Vëllimi Org. Org. Jedis. Org. Unit	Shif. Masif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Prot. No. No. Pages	Nr. i Stranica Str. No.
Nr. i Kopjeve No. Copies	Nr. i Diteve Date	Nr. i Diteve Date	Nr. i Diteve Date
23	30	05	25
Prishtine / a			

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës

Ministarstvo Inostranih Poslova i Dijaspore - Ministry of Foreign Affairs and Diaspora

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar/a,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e pasqyrave financiare vjetore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raport");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

z. Kreshnik Ahmeti

Zëvendësministër në Detyrë i Punëve të Jashtme dhe Diasporës

Data: 27 maj 2025, Prishtinë



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.